



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 23.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.05.2024 të parashtruar nga "CAPITAL X FET " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së ", Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-221, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik " CAPITAL X FET " SH.P.K., e dt.20.05.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së ", Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-221, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 13.05.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 13.05.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik " CAPITAL X FET " SH.P.K. me dt.20.05.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e objekteve-

pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së “ , Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 23.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Përgjigje pretendimeve për GOE PE-VLA-KU sh.p.k.-Dega në Kosovë, Pastrime Silvio sh.p.k.:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse ky Grup i Operatorëve ekonomik e ka dorëzuar marrëveshjen për formimin e konzorciumit ku lider caktohet Pastrime Silvio sh.p.k..Nuk është e domosdoshme që lideri i grupit të dorëzojë dosjen e tenderit. Lideri i grupit caktohet me marrëveshje e jo sipas asaj se emri i cilit anëtarë të GOE është shënuar i pari apo cili e ka dorëzuar ofertën.

Pretendimi juaj i dytë, gjithashtu nuk qëndron, sepse lider i grupit nuk është PE-VLA-KU sh.p.k.-Dega në Kosovë, por Pastrime Silvio sh.p.k, gjë e cila dëshmohet me marrëveshjen për bashkëpunim-konzorcium.

Po e ri përsërisim, se lideri grupit nuk është ai i cili dorëzon ofertën po ai i cili është caktuar me marrëveshjen për bashkëpunim-konzorcium. Pretendim i juaji se lider i grupit është PE-VLA-KU sh.p.k.-Dega në Kosovë, dhe i njëjti nuk ka dorëzuar asnjë kontratë të natyrës së ngjashme, nuk qëndron, sepse lideri i grupit është Pastrime Silvio sh.p.k. dhe me dokumentet e prezantuara mbulon kërkesat e FDT-së.

Pretendimi se Pastrime Silvio sh.p.k, shumicën e kontratave me vlerë të madhe i ka me afat të skaduar nuk qëndron sepse në FDT-ë dhe Njoftimin për kontratë kërkohet dorëzimi i kontratave të kryera në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë që d.m.th. përfshinë kontratat e realizuara në vitet 2020,2021 dhe 2022, sepse Njoftimi për kontratë është publikuar me dt.09.11.2023, prandaj kontratat e prezantuara nga ky operator janë brenda afatit.

Pretendimi lidhur me aneksin 1, nuk qëndron sepse, të dy anëtarët e grupit , kanë deklaruar se do të përmbushin specifikimet teknike të detyrueshme.

Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Lënda: Deklaratë për specifikime teknike

Kompania " PASTRIME SILVIO" SH.P.K, deklaron se do i përmbahet specifikimeve teknike të detyrueshme për punët e ofruara e cila përputhet me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Për tenderin: **Mirëmbajtja e objekteve – pastrimi i objekteve te KPSH-se dhe QPS-se**

Nr.Prokurimit: 632-23-11804-2-1-1

Data: 04.04.2024

Administrator :
Bule Allmuça





“PE-VLA-KU” Sh.p.k

Ad: Rruga: Tringë Smajli, 16/7, Prishtine, Kosove Email: pevlaku.ks@qmail.com

Data: 04.04.2024

**Zyrës së Prokurimit
Komuna e Gjakovës**

Lënda: Deklaratë për specifikime teknike

Kompania **“PE-VLA-KU” SH.P.K- Dega ne Kosove** deklaron se do t'i përmbahet specifikimeve teknike të detyrueshme për punët e ofruara të cilat përpunohen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Për tenderin: **Mirëmbajtja e objekteve – pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së**

Nr.Prokurimit: **632-23-11804-2-1-1**

**Përfaqësues për Kosovë
Arben SADRIJA**



Pretendimi juaj lidhur me pagat e punëtorëve nuk qëndron, sepse Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë ka deklaruar se pagesat e punëtorëve do të kryhen me dt.5 të muajit paraprak, pavarësisht mos pagesave të bëra apo vonesës nga Autoriteti kontraktues.

Data: 04.04.2024

PËR : Zyrën e Prokurimit - KOMUNA E GJAKOVËS

NGA : JV: " PASTRIME SILVIO" Sh.P.K & " PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove

DEKLARATË

Konzerciumi JV: " PASTRIME SILVIO" Sh.P.K & " PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove me numër unik identifikues: K91413010N dhe 810794463 :

Deklarojmë me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë dhe se mbajmë përgjegjësi juridike për deklaratën e dhënë se pagat e çdo punëtori do te paguhen çdo here sipas kërkesës se dosjes se Autoriteti Kontraktues: Komunës se Gjakovës me datën 05 te çdo muaji paraprak edhe përkundër mos pagesës se bere apo te vonuar nga Autoriteti Kontraktues.

Deklaruesi :

JV: " PASTRIME SILVIO" Sh.P.K & " PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove

Bule Allurise
Bu



Pretendimi juaj lidhur me atë se Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë, nuk ka paraparë pagën e menaxherit për 36 muaj siç kërkohet në Aneksin 1 të Specifikimit teknike të detyrueshme, nuk qëndron sepse Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë, këtë e ka përfshitë në analizën financiare .

Përgjigje pretendimeve për GEO SKYFTERAT – LIVE SHPK dhe INTERNACIONAL GROUP :

Pretendimi i parë nuk qëndron, sepse Aneksi 6 është i nënshkruar dhe i vulosur nga GEO SKYFTERAT – LIVE SHPK dhe INTERNACIONAL GROUP .

Pretendimi i dytë nuk qëndron, sepse Kontratat ne piken 1,2,3,4 dhe 5 janë kontrata te vitit 2020 dhe pika 6 dhe 7 janë kontrata te vitit 2021. Në FDT-ë dhe Njoftimin për kontratë kërkohet dorëzimi i kontratave të kryera në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë, që d.m.th. përfshinë kontratat e realizuara në vitet 2020,2021 dhe 2022.

Pretendimi i tretë nuk qëndron, sepse Aneksi 1 te GEO SKYFTERAT – LIVE SHPK dhe INTERNACIONAL GROUP BASE SHPK është llogaritur paga baze për punonjësit ashtu si është kërkuar ne njoftimin për kontratë te datës 09.11.2023.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

